

GERMAN LANGUAGE IN THE DIGITAL DEVELOPMENT

Shadan RAMADANI¹

¹Gjuhë dhe letërsi gjermane – Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës
e-mail: shadan.ramadani@unite.edu.mk

Abstract

We are all witnessing the digital revolution which nowadays, has a lot of influence in the communication and society. Recent discoveries in the information and communication technology are sometimes compared with the novation of Gutenberg's printing machine. However, how does this digitalization of information, knowledge and communication daily affect the language? Will the language change or will it disappear completely? It is estimated that, at least 2000 languages are destined to disappear in the next decades and their role will decrease heavily without having any influence in the academic world. What is the state of the German language at this point? With approximately 100 million speakers, the German language is well-positioned compared to the German language persists. Despite its decrease in the international stage, the German language continues to be the second most-studied language in Europe. Due to Europe's integration history in the 20th century, Germany and Austria never demanded to give more recognition to the German language from the administration of the European Union. However, the German language has a very high status in terms of contracts and treaties of the Union.

Keywords: *German language, communication technology, digital revolution*

Abstrakti

Të gjithë jemi dëshmitarë të revolucionit digjital, i cili sot ka një ndikim shumë të rëndësishëm në komunikim dhe shoqëri. Zbulimet e fundit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit janë krahasuar nganjëherë me novacionin e Gutenberg-ut për shtypin e shkruar. Por çfarë ndikimi kanë te gjuha gjithë ky digjitalizim i informacionit, dijes dhe komunikimit të përditshëm? Do të ndryshojë gjuha apo edhe të zhduket? Është vlerësuar se së paku 2000 gjuhë janë të destinuara drejt zhdukjes në dekadat e ardhshme, roli i tyre do të zvogëlohet ndjeshëm dhe nuk do të kenë ndikim në botën akademike. Cilat janë gjasat e mbijetesës së gjuhës gjermane? Me pothuajse 100 milionë folës, gjermanishtja është shumë mirë e pozicionuar në krahasim me gjuhët e tjera.

Pavarësisht rënies së theksuar të rolit të saj ndërkombëtar, gjuha gjermane vazhdon të jetë gjuha e dytë më e studiuar në Evropë. Për shkak të historisë së integrimit të Evropës në shekullin XX, Gjermania dhe Austria nuk kanë kërkuar që gjermanishtes t'i jepet njohje më e gjerë nga administrata e Bashkimit Evropian, megjithatë ka mjaftueshëm një status më të lartë në kontratat dhe traktatet e Unionit.

Fjalë kyçe: *gjuha gjermane, teknologjia e komunikimit, revolucion digjital.*

1. Hyrje

Gjuha është pjesë kryesore e kulturës dhe identitetit tonë individual, ajo është e përhershme ndërsa teknologjia po ndryshon në mënyrë të rrënjësishme jetën tonë. Historia evropiane është, në mënyrë metaforike, një depo e madhe e kulturave dhe traditave të ndryshme të vendosura ndër shekuj në rrjedhën e ngjarjeve në disa raste bashkëpunimi dhe integrimi dhe në të tjera, më të shpeshta, në konflikte.

Megjithatë pikërisht këto kultura dhe gjuhë përbëjnë sot identitetin evropian, i cili nuk mund të zvogëlohet as në një dimension të vetëm, as në një rrënjë të vetme. Sot, me globalizimin

teknologjik, jo vetëm udhëtari në kuptimin fizik, por edhe ai udhëtari virtual, përjeton dhe e ndan përvojën e vet edhe nga shtëpia kudo qoftë. Gjithsesi vetëm dy dhjetëvjeçarët e fundit po bëhet gjithnjë e më e qartë se digjitalizimi po ndikon në jetën tonë në të gjitha fushat e saj, por duhet theksuar se një gjë është e sigurt: „digjitalizimi nuk është një trend që po kalon, ai paraqet themelin mbi të cilin në të ardhmen do të bazohen ekonomia, shkenca dhe shoqëria“¹⁹.

Ndërsa shtypi i shkruar ndihmoi në rritjen e shkëmbimit të informacionit në Evropë, ai gjithashtu çoi në zhdukjen e shumë gjuhëve. Gjuhët rajonale dhe ato të pakicave ishin më pak të pranishme në shtypin e shkruar gjë që kufizonte shtrirjen e tyre të përdorimit. Por a do të ketë interneti të njëjtin ndikim në gjuhët tona moderne? Sigurisht që nuk mund të parashikojmë se si do të duket shoqëria e ardhshme, sidoqoftë, revolucioni në teknologjinë e komunikimit po sjell njerëz, që flasin gjuhë të ndryshme së bashku, në mënyra të reja. Kjo u bën presion individëve për të mësuar gjuhë të reja dhe veçanërisht për zhvilluesit/developers që të krijojnë teknologji të re në mënyrë që të sigurojnë një mirëkuptim të ndërsjellë dhe të ndajnë njohuritë me njëri-tjetrin. Në hapësirën globale ekonomike dhe të informacionit, ka ndërveprim në rritje midis gjuhëve të ndryshme, folësve dhe përmbajtjes falë llojeve të reja të mediave.

2. Gjermanishtja, vendi që zë në Evropë

Me rreth 100 milionë folës, gjermanishtja është gjuha amtare më e folur në Bashkimin Evropian. Flitet zakonisht në Gjermani, Austri dhe Lihtenshtajn si dhe është një nga gjuhët zyrtare të Zvicrës, Luksemburgut dhe Belgjikës, ku përdoret nga një pjesë e konsiderueshme e popullsisë. Në mbarë botën, gjermanishtja flitet nga rreth 30 milionë folës jokombëtarë dhe është gjithashtu gjuha e dytë e huaj më e studiuar në BE²⁰. Në Gjermani, gjuha gjermane është gjuha e zakonshme e folur dhe e shkruar, si dhe gjuha amtare e shumicës dërrmuese të popullsisë. Për më tepër, ka gjuhë emigruese, siç është turqishtja, e cila ka afërsisht 3.3 milionë folës në Gjermani. Në Austri dhe Lihtenshtajn, gjermanishtja është gjuha zyrtare, si dhe gjuha më e zakonshme e folur dhe e shkruar. Në Austri, gjuhët e minoriteteve të njohura përfshijnë atë sllovene, kroate (die burgenlandkroatische Sprache), sllovake, romane, hungareze dhe çeke. Gjuhët e emigrantëve që fliten në Austri janë turqishtja dhe gjuhët e ish-Jugosllavisë (boshnjakisht, kroatisht, serbisht).

Ndarja e Gjermanisë në dy vende përgjatë viteve 1945 dhe 1989 reflektohet ende në disa dallime leksikore, siç është për shembull: Plastik (perëndim) ose Plaste (lindje). Gjermanishtja shfaq një numër karakteristikash specifike që kontribuojnë në pasurinë e gjuhës, por gjithashtu mund të jenë një sfidë për përpunimin llogaritës të gjuhës natyrale²¹. Për shembull, folësit mund të shprehin të njëjtën ide në një larmi mënyrash. Renditja e fjalëve është relativisht e lirë në fjalitë gjermane dhe njëkohësisht shumë komplekse. Megjithatë duhet nënvizuar se në Gjermani nuk ka një institucion përgjegjës sa i përket zhvillimit apo strategjive të reja për ta mbrojtur gjuhën gjermane përballë sfidave të reja që mbart me vete epoka teknologjike. Sidoqoftë, ekzistojnë një numër organizatash joqeveritare, të financuara nga publiku, të cilat luajnë një rol aktiv në

¹⁹ Rühl, Monika / Karrer, Heinz (2017): Economiesuisse. Think Tank W.I.R.E. Zürich. fq. 5

²⁰20 Lothar Lemnitzer (2007) Von Aldianer bis Zauselquote (From Aldianer to Zauselquote). Tübingen.

²¹Krhttp://www.canoo.net/services/GermanSpelling/Reform/fremdwoerter/eindeutschung-lebend.jsp?MenuId=GermanSpellingReform111. Online më 08.11.2019.

promovimin e gjuhës gjermane. Instituti Goethe punon në partneritet me Zyrën Federale të Jashtme, duke ofruar kurse të gjuhës gjermane në të gjithë botën për të forcuar pozicionin ndërkombëtar të gjuhës gjermane.

Organizata të tjera që rrisin ndërgjegjësimin për gjuhën gjermane dhe promovojnë kulturën e gjuhës gjermane, përfshijnë Akademinë Gjermane për gjuhë dhe letërsi (DASD) dhe Shoqërinë për Gjuhën Gjermane (GfdS), e cila është e angazhuar nga Bundestagu (Parlamenti Federal) për kontrollimin e gjuhës dhe teksteve legislative. Fjalori Duden dikur ishte një burim për drejtshkrimin dhe gramatikën gjermane, por tani kërkon një qasje më përshtatëse.

3. Gjuha gjermane në internet

Gjermania, e njohur ndryshe edhe si vendi i „Dichter und Denker (poetëve dhe mendimtarëve)“ për shkak të kontributeve të mëdha në letërsi, filozofi dhe shkencë, duhet theksuar se kjo ka bërë që të ketë gjithmonë një ndikim të qëndrueshëm në kulturën moderne. Në fillim të shekullit të 20-të, vendet që flasin gjermanisht ishin në ballë të disiplinave shkencore dhe gjermanishtja ishte gjuha kryesore e shkencës: 30% e botimeve shkencore ishin shkruar në gjermanisht²². Ndërsa sot kemi një rënie të madhe sa i përket këtyre botimeve shkencore, vetëm 5% prej tyre aktualisht janë shkruar në gjermanisht, shumica e tyre në disiplina të tilla si ligji, filozofia dhe teologjia. Por çfarë roli luan sot gjuha gjermane në internet?! Sipas të dhënave statistikore në vitin 2019, pothuajse 89% e popullsisë gjermane²³ dhe 87% e popullsisë austriake²⁴ janë përdorues të internetit ndërsa përqindja e të rinjve që përdorin internetin është edhe më e lartë në të dy vendet.

Prania e fortë e gjermanishtes në ueb pasqyrohet edhe nga fakti se wikipedia gjermane është wikipedia e dytë më e madhe pas anglishtes. Me rreth 16.2 milionë faqe të internetit në tetor të vitit 2019, domeni i vendit të nivelit të lartë (.de) për Gjermaninë është shtrirja më e madhe e vendit në botë dhe është në top dhjetëshen pas faqes (.com).²⁵ Kjo prani mbizotëruese e internetit sugjeron që ekziston një sasi e madhe e të dhënave në gjuhën gjermane në ueb. Për më tepër, disa burime dygjuhëshe, si fjalori në internet LEO, janë në dispozicion falas²⁶.

Revolucioni digjital, në këtë aspekt, ka parashtruar para gjuhëtarëve/linguistëve çështje tjera, duke u pajtuar se ky fenomen i filluar në vitet tetëdhjetë dhe nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, kërkon një ristandardizim të gjermanishtes. Sepse gjuha për të cilën flitet sot, është në evolucion të vazhdueshëm si pasojë e përhapjes së teknologjisë. Mjafton të përmendim një shembull të thjeshtë si emaili apo chat-i, të cilat janë mjetet kryesore sot të komunikimit në internet.

Email-i, e ashtuquajtura posta elektronike, i referohet transmetimit të mesazhit/lajmit në formë elektronike në rrjetet kompjuterike, dhe pothuajse të gjithë tashmë kanë një adresë email-i dhe të njëjtat kontrollohen një herë në ditë ose më shumë nga përdoruesit. Ndërsa nëse do ta

²² <http://www.pauljoycegerman.co.uk/abinitio/whygerm7.html>. Online më 08.11.2019.

²³ <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/36146/umfrage/anzahl-der-internetnutzer-in-deutschland-seit-1997/>. Online më 13.11.2019.

²⁴ <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/315040/umfrage/anzahl-der-internetnutzer-in-oesterreich/>. Online më 13.11.2019.

²⁵ <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/39530/umfrage/entwicklung-der-domainzahl-mit-endung-de/>. Online më 13.11.2019.

²⁶ http://www.statistik.at/web_en/statistics/information_society/ict_usage_in_households/041019.html. Online më 08.11.2019.

krahasojmë postën elektronike me letrat tradicionale është i pakontestueshëm fakti se posta elektronike tashmë ka një rëndësi të theksuar dhe të menjëhershme situative, e cila shpjegohet brenda intervaleve të shkurtra ndërmjet mesazhit dhe përgjigjes.²⁷ Në praktikë kjo mund të ndryshojë duke e zvarritur periudhën e përgjigjes nga pranuesi (pranuesi nuk është online).

Chat-i, uebchat-i dhe online chat-i konsiderohen si komunikim sinkron. Duke pasur parasysh mundësinë në chat për të kontaktuar 24 orë në ditë, i cili mundëson transmetim sinkronik, krijon përshtypjen e „të folurit me shkrim“.²⁸ Të folurit konceptual rezulton si nga stili gjuhësor i bazuar në situata po ashtu edhe nga transmetimi sinkronik i të dhënave.²⁹ Por sa i saktë është komunikimi në chat kur e dimë se nickname/pseudonimi është çelësi për të kontaktuar? Grupet e krijuara në chat janë thelbësore dhe karakterizohen në bazë të pseudonimeve, pasi që ata vendosin nëse një komunikim do të zhvillohet ose jo. Shpesh komunikimi është shumë i hollësishëm nga i cili mund të vlerësohet shtresa shoqërore:

„A: mein C

B: C... Halloele

C: moin!

C: Hi

D: huhu C

E: Morgen!!!!

C: huhuhuhu“³⁰

Gjithashtu vlen të përmendet se edhe literatura ka gjetur vendin në internet si një vend botimi dhe publikimi. Sikurse në librat tradicionale, tekstet kanë një strukturë lineare dhe interneti u shërben vetëm si një mjet mediatik për regjistrim, ruajtje dhe diskutim të literaturës përkatëse³¹. Një projekt i rëndësishëm në këtë drejtim përfaqësohet nga „Projekt Gutenberg“ dhe njihet si një arkiv qendror për libra elektronike, në të cilin kanë qasje të gjithë pjesëmarrësit e internetit.³²

4. Ndryshimi i komunikimit dhe ndërveprimit

Gjuha në rrjetet sociale ka ndryshuar në mënyrë drastike. Duke u bërë gjithnjë e më shumë informal, komunikimi dhe ndërveprimi i shpejtë kanë kontribuar në këtë ndryshim dhe gjuha gjermane nuk bën përjashtim. Karakteristikë e formave të tilla digjitale të komunikimit është një gjuhë e thjeshtë, por koncize, ndërsa komunikimi shpesh zhvillohet në fragmente sesa në fjali të plota, në mënyrë që qëllimi të vihet në mënyrë më të përmbledhur. Komunikimi vizual gjithashtu

²⁷ Kaden B. / Kindling M. (2005): Websprache.net. Sprache und Kommunikation im Internet. Berlin.

²⁸ Sandbothe M. (1997): Digitale Verflechtungen. Eine medienphilosophische Analyse von Bild, Sprache und Schrift im Internet. Berlin. fq. 145-157.

²⁹ Siever T. / Schlobinski P. / Runkehl J. (2005): Websprache.net. Sprache und Kommunikation im Internet. Walter de Gruyter (Hrsg.), Berlin.

³⁰ Runkehl, J. / Schlobinski, P. / Siever, T. (1998): Sprache und Kommunikation im Internet Einstieg NETWORKX – Online-Publikationen zum Thema Sprache und Kommunikation im Internet. Online: <http://www.websprache.uni-hannover.de/networkx/>. Online, më 09.11.2019. fq. 93.

³¹ Bauer, K. (2003): Kriterien digitaler Literatur. Eine exemplarische Untersuchungen zu Definitionen und Ansätzen digitaler Literatur. Wien.

³² Runkehl, J. Schlobinski, P. & Siever, T. (1998). Sprache und Kommunikation im Internet Einstieg NETWORKX – Online-Publikationen zum Thema Sprache und Kommunikation. Online: <http://www.websprache.uni-hannover.de/networkx/> Online, më 10.11.2019

funksionon shumë mirë sepse drejtpërdrejt adreson ndjenjat tona. Disa fotografi na bëjnë të qeshim dhe kështu kemi një potencial të madh emocionues. Për shembull, gjatë komunikimeve tona digjitale, ne mund të bëjmë shpejt dallimin midis mesazheve pozitive dhe negative bazuar në figurën që përdorim. Por gjuha e përdorur në internet nuk është se ka një besueshmëri të fortë shkencore dhe kjo përbën edhe një shqetësim të shoqërisë në tërësi me përgjegjësi të orientuar drejt së ardhmes.

Sado interesante dhe e saktë duket se e ardhmja e gjuhës gjermane - dhe e gjuhëve të tjera - është shumë më e ndikuar nga fakti se teknologjia ka një pjesë gjithnjë e në rritje të komunikimit, ajo është pak a shumë e përfshirë direkt ose indirekt në proceset e transferimit në mediumin e gjuhës. Në fakt gjithnjë e më shpesh gjuhëtarët gjermanë po japin alarmin se gjuha gjermane po pëson një ndryshim masiv të shoqëruar nga varfërimi i saj për shkak të mediave online³³.

Kritikët kanë frikë se gjuha gjermane vuan nga ndikimi i mediave të reja dhe se si drejtshkrimi ashtu edhe gramatika janë në rrezik. Sipas mendimit të Josef Krausit, presidentit të shoqatës së mësuesve gjermanë deri në vitin 2017, “fjalori i studentëve po varfërohet po aq sa edhe saktësia gramatikore. Por shumë faktorë janë përgjegjës, jo vetëm SMS dhe posta elektronike. Mbi të gjitha, studentët lexojnë më pak se më parë.”³⁴.

Në një hulumtim të kryer për ndikimin që ka digjitalizimi në gjuhën dhe komunikimin e përditshëm shumica e gjuhëtarëve të anketuar (62%) supozojnë se rritja e komunikimit digjital në gjuhën gjermane në popullatën e përgjithshme ka një ndikim të madh. 33 për qind e vlerësojnë si një ndikim më të vogël ndërsa vetëm 5% e të anketuarve mendojnë se nuk ka aspak ndikim.

Tabela nr. 1³⁵

	Shumë ndikim %	Pak ndikim %	Aspak ndikim %
gjuhëtarët	62%	33%	5%
meshkujt	60%	33%	7%
femrat	64%	33%	3%
Nën moshën 45- vjeçare	68%	28%	4%
Mbi moshën 45- vjeçare	54%	40%	6%

Në një kohë kur ky brez por edhe ata që do të vijnë, po mbizotërojnë gjuhën e njeriut - të paktën në atë masë sa njerëzit të komunikojnë me teknologjinë në gjuhën e tyre dhe që teknologjia

³³ Die Welt Online, 21.12.2012, Twitter, Anglizismen und Abkürzungen wie ‚HDL‘ gefährden die Sprachkompetenz ganzer Generationen“

³⁴ <https://tilo-hensel.de/merkmale-der-sprache-in-den-neuen-medien-und-veraenderung-der-sprache-durch-die-neuen-medien>

³⁵ <http://www.gfds.de/presse/pressemitteilungen/130608-einstellung-der-deutschen-zur-sprache/einstellung-der-deutschen-zu-den-deutschen-dialekten/>

mund të nxjerrë automatikisht informacionin më të rëndësishëm nga njohuritë digjitale në botë, gjuha gjermane është pjesë e pandashme e këtij procesi.

Përdorimi i interneti dhe mundësitë e komunikimit janë të padiskutueshme në ditët e sotme. As fakti që interneti buron nga gjuha angleze nuk mund të mohohet. Chati dhe posta elektronike na mundësojnë që të komunikojmë shpejt, lirë dhe me lehtësi. Por nëse do të trajtohet gjuha në chat shpesh hasim në shprehjen “Sprachmonster/Përbindësh i gjuhës”. Nëse vështrohet komunikimi në internet mund të konkludohet se së pari injorohet drejtshkrimi dhe pastaj largohen edhe shkronja si për shembull shprehja “Woipen” përdoret për të telefonuar në internet (Voice-over-IP) dhe kjo praktikë dhe shumë praktika tjera i takojnë fjalorit standard të përdoruesve të rrjetit. Problemi vështirësohet edhe më shumë kur fjalitë e plota përbëhen vetëm nga fjalë që janë plotësisht fiktive ose të shkurtuara.

Në shembullin “Download mal das Proggi zum Foten, da funzt”³⁶ është një shembull nga shumë shembuj ku mund të kuptojmë vetëm fjalën “download”. “Proggi” do të thotë Programm/program, “foten” supozohet të jetë për fotografieren/fotografim dhe “funzt” për funktioniert/funksionon.

Ky shembull tregon mirë se ata/o përdorues të internetit që nuk e kuptojnë këtë fjalor nuk kanë asnjë shans për të komunikuar në këto forume. Sikur të përdorej kjo gjuhë e internetit në komunikim face-to-face, siç e përdorin shumica e të rinjve, atëherë kjo mund të çojë në barriera, veçanërisht nëse flitet saktësisht ashtu sikur edhe në chat.

Ashtu si e theksuam edhe më lart, Gjermania këto tri dekadat e fundit nuk është se ka zhvilluar industrinë e teknologjisë së gjuhës gjermane, ajo vazhdon të mbetet e fragmentarizuar dhe e çorganizuar. Nuk ka përpjekje thelbësore për të krijuar një gjuhë dhe burime të teknologjisë për gjermanishten, si një mjet për të ecur përpara sa u përket hulumtimeve, inovacionit dhe zhvillimit.

5. Konkluzionet

Gjuhët dhe revolucioni digjital janë bërë një nga çështjet më të hulumtuara bashkëkohore për shkak se gjuhëtarët duan të dinë më shumë për zhvillimin dhe komunikimin teknologjik, përpunimin e informacionit dhe mësimin. Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë ka nxitur mënyra të reja ndërveprimi, komunikimi nga ana tjetër, mënyra të reja edhe të të mësuarit apo menaxhimit të dijes.

Digjitalizimi po depërton me një forcë shumë të madhe në të gjitha fushat e jetës, duke mbartur me vete pasojat negative dhe pozitive. Por statusi i një gjuhe varet jo vetëm nga numri i folësve dhe nga numri i librave, por sot në këtë kohë gjithnjë e më shumë nga prania e gjuhës në hapësirën e informacionit digjital dhe produktet e programeve në dispozicion për atë gjuhë. Në këtë këndvështrim gjuha gjermane po përballlet me sfida të shumta e zhvillimin e teknologjisë.

Përdorimi masiv i sistemeve interaktive në internet ka shtruar nevojën për një teknologji gjuhësore me përshtatshmëri të lartë tek folësit e varianteve të ndryshme të gjermanishtes. Gjithashtu nga njëra anë pasurimin e saj si gjuhë, dhe, nga ana tjetër, përkujdesin dhe mbrojtjen e saj nga varfërimi. Me gjithë përparimet e konsiderueshme të teknologjisë gjuhësore ekziston ende për të përmirësuar cilësinë e gjuhës në këto sisteme.

³⁶Bucher, Martina / Schmidt, Agnes (2009): Sprache und Kommunikation im Internet. Online: <https://www.uibk.ac.at/psychologie/mitarbeiter/leidlmair/einfuehrung.pdf>. Online më 11.11.2019. Fq. 23.

Referencat

- [1]. Bauer, K. (2003): Kriterien digitaler Literatur. Eine exemplarische Untersuchungen zu Definitionen und Ansätzen digitaler Literatur. Wien.
- [2]. Bucher, Martina / Schmidt, Agnes (2009): Sprache und Kommunikation im Internet. Online: <https://www.uibk.ac.at/psychologie/mitarbeiter/leidlmaier/einfuehrung.pdf>.
- [3]. Die Welt Online, 21.12.2012, Twitter, Anglizismen und Abkürzungen wie ‚HDL‘ gefährden die Sprachkompetenz ganzer Generationen
- [4]. Kaden B. / Kindling M. (2005): Websprache.net. Sprache und Kommunikation im Internet. Berlin.
- [5]. Lothar Lemnitzer (2007) Von Aldianer bis Zauselquote (From Aldianer to Zauselquote). Tübingen.
- [6]. Rühl, Monika / Karrer, Heinz (2017): Economiesuisse. Think Tank W.I.R.E. Zürich.
- [7]. Runkehl, J. / Schlobinski, P. / Siever, T. (1998): Sprache und Kommunikation im Internet Einstieg NETWORK – Online-Publikationen zum Thema Sprache und Kommunikation im Internet.
- [8]. Sandbothe M. (1997): Digitale Verflechtungen. Eine medienphilosophische Analyse von Bild, Sprache und Schrift im Internet. Berlin.
- [9]. Siever T. / Schlobinski P. / Runkehl J. (2005): Websprache.net. Sprache und Kommunikation im Internet. Walter de Gruyter (Hrsg.), Berlin.
- [10]. <https://tilo-hensel.de/merkmale-der-sprache-in-den-neuen-medien-und-veranderung-der-sprache-durch-die-neuen-medien>
- [11]. <http://www.pauljoycegerman.co.uk/abinitio/whygerm7.html>.
- [12]. http://www.statistik.at/web_en/statistics/information_society/ict_usage_in_households/041019.html.
- [13]. <http://www.canoo.net/services/GermanSpelling/Reform/fremdwoerter/eindeutschung-lebend.jsp?MenuId=GermanSpellingReform111>
- [14]. <http://www.gfds.de/presse/pressemitteilungen/130608-einstellung-der-deutschen-zur-sprache/einstellung-der-deutschen-zu-den-deutschen-dialekten/>
- [15]. <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/36146/umfrage/anzahl-der-internetnutzer-in-deutschland-seit-1997/>
- [16]. <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/315040/umfrage/anzahl-der-internetnutzer-in-oesterreich/>
- [17]. <https://de.statista.com/statistik/daten/studie/39530/umfrage/entwicklung-der-domainzahl-mit-endung-de/>